<p>pronësinë përfituese.</p> <p>3.2. Subjektet raportuese duhet të përcaktojnë nëse ekziston ndonjë formë tjetër e kontrollit të klientit ose transaksionit.</p> <p>4. Kryerja e kontrolleve të PPP/LFT dhe zbatimi i masave të kujdesit ndaj klientët</p> <p>Për të gjithë klientët që gjatë zbatimit të hapave të lartcekur në këtë nen janë përcaktuar të jenë pronarë përfitues, duhet të kryhen kontrolle për PPP/LFT dhe zbatohen masat e kujdesit ndaj klientit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Identifikimi i Pronarëve Përfitues</p> <p>1. Për klientët që janë persona juridik ose marrëveshje ligjore, subjektet raportuese duhet të kuptojnë natyrën e biznesit të klientit dhe strukturën e tij të pronësisë dhe kontrollit, përfshirë nëse personi juridik ose marrëveshja ligjore përfshihet në marrëdhëniet me klientët, por nuk është klienti.</p>	<p>vlasništvo.</p> <p>3.2. Izveštalički subjekt mora utvrditi da li postoji bilo koji drugi oblik kontrole klijenta ili transakcije.</p> <p>4. Kontrola SPN/BPFT i primena mera pažnje u pogledu klijenata</p> <p>Kod svih klijenata za koje prilikom sprovođenja gore navedenih koraka bude utvrđeno da su stvarni vlasnici treba izvršiti kontrolu u smislu SPN/BPFT i primeniti mere pažnje u pogledu klijenta.</p> <p style="text-align: center;">Član 7. Utvrđivanje stvarnih vlasnika</p> <p>1. Za klijente koji su pravna lica ili pravni ugovori, obveznici izveštavanja treba da shvate vrstu klijentovog poslovanja i strukturu njegovog vlasništva i kontrole, uključujući i to da li je pravno lice ili pravni aranžman uključen u odnos sa klijentima, ali nije klijent.</p>	<p>ownership.</p> <p>3.2. Reporting entities must establish whether there are is any other form of control on the customer or a transaction.</p> <p>4. Perform PML/CTF audits and implement customer due diligence measures</p> <p>To all customers, who during the implementation of the above steps in this article are stipulated to be the beneficial owners, PML/CFT controls must be conducted and measures of customer due diligence applied.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Identification of Beneficial Owners</p> <p>1. Reporting entities must understand the nature of the client's business and its ownership and control structure for clients that are legal entities or legal arrangements, including whether legal person or legal arrangements is included in clients relationship but is not the client</p>
---	--	---

<p>2. Për klientët që janë persona juridik ose marrëveshje ligjore, subjektet raportuese duhet të identifikojnë klientin dhe të verifikojnë identitetin e tij përmes informacioneve si në vijim:</p> <p>2.1. emrin, formën ligjore dhe dëshminë e ekzistencës;</p> <p>2.2. kompetencat që rregullojnë dhe lidhin personin juridik ose marrëveshjen juridike, si dhe emrat e personave përkatës që kanë pozitë të lartë menaxhuese në personin juridik ose marrëveshje juridike; dhe</p> <p>2.3. adresa e zyrës së regjistruar dhe, nëse është e ndryshme, vendin kryesor të biznesit.</p> <p>3. Për klientët që janë persona juridik, subjektet raportuese duhet të identifikojnë dhe të marrin masa të arsyeshme, bazuar në rrezik për të verifikuar identitetin e pronarëve përfutues përmes informacionit të mëposhtëm:</p> <p>3.1. personi fizik i cili ka kontrollin e interesit të pronësisë në një person</p>	<p>2. Za kljente koji su pravna lica ili pravni ugovori, obveznici izveštavanja treba da utvrde i verifikuju identitet kljenta pomoću sledećih podataka:</p> <p>2.1. naziv, pravni oblik i dokaz o postojanju;</p> <p>2.2. ovlašćenja koja uređuju i obavezuju pravno lice ili pravni ugovor, kao i imena onih lica koja imaju visoke rukovodeće pozicije u pravnom licu ili pravnom ugovoru; i</p> <p>2.3. adresa sedišta i, ukoliko se razlikuje, glavno mesto poslovanja.</p> <p>3. Za kljente koji su pravna lica, obveznici izveštavanja treba da utvrde i preduzmu razumne mere, zasnovane na riziku, kako bi verifikovali identitet stvarnih vlasnika pomoću sledećih podataka:</p> <p>3.1. fizičko lice koje ima kontrolu nad vlasničkim udelom u pravnom</p>	<p>2. Reporting entities must identify the client and verify its identity through the following information for clients that are legal persons or legal agreements:</p> <p>2.1. name, legal form and evidence of existence;</p> <p>2.2. the powers that regulate and bind the legal person or the legal arrangement, as well as the names of the respective persons who hold a senior management position in the legal person or legal arrangement; and</p> <p>2.3. the address of the registered office and, if different, the principal place of business.</p> <p>3. Reporting entities must identify and take reasonable, risk-based measures to verify the identity of beneficial owners for clients who are legal entities, through the following information:</p> <p>3.1. the natural person who has control of the ownership interest in a</p>
--	---	---

<p>juridik; ose nëse asnjë person i tillë fizik nuk ekziston ose nuk mund të identifikohet, (veprohet sipas paragrafit 3.2 të këtij neni);</p> <p>3.2. personi fizik i cili përfundimisht kontrollon personin juridik nëpërmjet mjeteve; ose nëse asnjë person i tillë fizik nuk ekziston ose nuk mund të identifikohet, (veprohet sipas paragrafit 3.3 të këtij neni)</p> <p>3.3. personi fizik i cili mban pozitën e zyrtarit të lartë menaxhues tek personi juridik.</p> <p>4. Për klientët që janë marrëveshje ligjore, subjektet raportuese duhet të identifikojnë dhe të marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarëve përfitues përmes informacionit të mëposhtëm:</p> <p>4.1. për trustet, identitetin e themeluesit, të besuarit, mbrojtësit (nëse ka), përfituesit ose klasën e përfituesve, si dhe çdo personi tjetër fizik që ushtron kontroll përfundimtar efektiv mbi trustin (përfshirë përmes një zinxhiri të kontrolli / pronësisë);</p>	<p>licu; ili da ne postoji takvo fizičko lice odnosno da ne može da se utvrdi, (postupa se u skladu sa stavom 3.2 ovog člana);</p> <p>3.2. fizičko lice koje u krajnjoj instanci kontroliše pravno lice sredstvima; ili da ne postoji takvo fizičko lice odnosno da ne može da se utvrdi, (postupa se u skladu sa stavom 3.3 ovog člana)</p> <p>3.3. fizičko lice koje zauzima visoki rukovodeći položaj u pravnom licu.</p> <p>4. Za klijente koji su pravni ugovori, obveznici izveštavanja treba da utvrde i preuzmu razumne mere kako bi verifikovali identitet stvarnih vlasnika pomoću sledećih podataka:</p> <p>4.1. za trustove, identitet osnivača, poverenika, zaštitnika (ako ga ima), korisnika ili klase korisnika, i svakog drugog fizičkog lica koje vrši krajnju efektivnu kontrolu nad trustom (uključujući putem lanca kontrole / vlasništva);</p>	<p>legal person; or if no such natural person exists or cannot be identified (acting in accordance with paragraph 3.2 of this Article);</p> <p>3.2. the natural person who ultimately controls the legal person through means; or if no such natural person exists or cannot be identified (acting in accordance with paragraph 3.3 of this Article)</p> <p>3.3. the natural person who holds the position of senior management officer in the legal person.</p> <p>4. Reporting entities must identify and take reasonable steps to verify the identity of the beneficial owners through the following information for clients that are legal arrangements:</p> <p>4.1. for trusts, the identity of the settlor, trustees, protector (if any), beneficiaries or class of beneficiaries, and any other natural person exercising effective final control over the trust (including through a chain of control / ownership);</p>
--	--	---

<p>4.2. për llojet e tjera të marrëveshjeve ligjore, identitetin e personave në pozicione ekuivalente ose të ngjashme.</p> <p>5. Legjislacioni në fuqi në Kosovë nuk njeh dhe nuk parasheh dispozita ligjore për themelimin e trusteve, megjithatë subjektet raportuese duhet kushtuar kujdes identifikimit dhe mos lejimit të shfrytëzimit të trusteve të krijuara në juridiksione të huaja që të përdoren për të fshehur kontrollin e pronësinë mbi pasuritë dhe të ardhurat.</p> <p>6. Trusti i huaj mund të themelohet në një juridiksion dhe të përdoret në një juridiksion tjetër për të mbajtur pasuritë nëpër juridiksion edhe për të maskuar origjinën e të ardhurave nga aktivitetet kriminale. Po ashtu mund të përdoret për të rritur anonimitetin, kështu duke shkëputur plotësisht pronarin përfitues nga emrat e palëve të tjera duke përfshirë të besuarin, administratorin, mbrojtësin ose përfituesin. Trustet e huaja po ashtu mund të mbajnë asete të rëndësishme të regjistruara në vend, p.sh. pasuri të paluajtshme, llogari bankare, makinë, jaht, dhe të tjera dhe të</p>	<p>4.2. za ostale vrste pravnih ugovora, identitet lica na tome saglasnim ili sličnim pozicijama.</p> <p>5. Važeći zakoni na Kosovu ne poznaju niti predviđaju zakonske odredbe o osnivanju trustova, ali obveznici izveštavanja moraju biti oprezni kod utvrđivanja i ne smeju da dopuste korišćenje stranih trustova za prikrivanje kontrole i vlasništva nad imovinom i prihodomima.</p> <p>6. Strani trust može da se osnuje u jednoj a koristi u drugoj juridikciji da drži imovinu širom obe juridikcije ali i da zamaskira poreklo prihoda stečenih kriminalnim radnjama. Može se još koristiti za jačanje anonimnosti, čime se stvarni vlasnik potpuno odvaja od imena drugih strana uključujući poverenika, upravnika, zaštitnika ili korisnika. Strani trustovi mogu takođe da drže znatnu imovinu registrovanu u zemlji, npr. nepokretnu imovinu, bankovne račune, automobile, jahte, itd; nude robu i usluge u zemlji domaćem poreskom obvezniku,</p>	<p>4.2. for other types of legal arrangements, the identity of persons in equivalent or similar positions.</p> <p>5. The legislation in force in Kosovo does not recognize and does not provide legal provisions for the foundation of trusts, however reporting entities should pay attention to the identification and not allow the use of foreign trusts to be used to conceal control over ownership of assets and income.</p> <p>6. The foreign trust can be founded in one jurisdiction and used in another jurisdiction to hold assets in through jurisdiction and to disguise the origin and proceeds of criminal activities. It can also be used to increase anonymity, thus completely detaching the beneficial owner from the names of other parties including the trustee, administrator, protector or beneficiary. Foreign trusts can also hold significant assets registered in the country, i.e. real estate, bank account, vehicle, yacht, and other things and provide goods or services in the country to resident</p>
--	---	---

<p>ofrojnë mallra ose shërbime në vend për tatimpaguesit rezidentë, edhe kur të ardhurat i nënshtrohen tatimit, apo mund të kenë ndonjërin nga palët rezident në vend, p.sh. pronarin ligjor, pronarin përfitues, drejtorin, të besuarin, etj. Andaj, për të i'u shmangur keqpërdorimit të mundshëm të trusteve të themeluar në juridiksione të huaja, subjektet raportuese duhet zbatuar masat kujdesit të duhur të shtuar ndaj klientit me qëllim të identifikimit dhe parandalimit të keqpërdorimeve të mundshëm të sistemit financiar dhe ofrimit të shërbimeve profesionale për trustet e huaja duke ndërmarrë hapa shtesë për identifikimin dhe verifikimin e tyre.</p>	<p>çak i kadrihodi podležu oporezivanju, ili mogu imati neku od rezidentnih strana u zemlji kao npr. stvarnog vlasnika, direktora, poverenika, itd. Dakle, da bi se izbegla moguća zloupotreba trustova osnovanih u stranoj jurisdikciji, obveznici izveštavanja treba da primene pojačane mere dužne pažnje u pogledu klijenata u cilju prepoznavanja i sprečavanja moguće zloupotrebe finansijskog sistema i pružanja profesionalnih usluga stranim trustovima uz preduzimanje pojačanih koraka za utvrđivanje i verifikaciju njihovog identiteta.</p>	<p>taxpayers, even when the income is subject to tax, or may have any of the resident party in the country, e.g. the legal owner, the beneficial owner, the director, the trustee, etc. Therefore, in order to avoid possible misuse of trusts founded in foreign jurisdictions, reporting entities should implement appropriate enhanced customer due diligence measures in order to identify and prevent possible misuse of the financial system and the provision of professional services for foreign trusts by taking additional steps to identify and verify them.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Identifikimi i pronarëve përfitues të OJQ</p>	<p style="text-align: center;">Član 8. Utvrdivanje identiteta stvarnih vlasnika NVO</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Identification of beneficial owners of NGOs</p>
<p>1. Për Organizata Jo Qeveritare të themeluara sipas Ligjit për Lirinë e Asocimit në Organizata Jo Qeveritare në Kosovë, subjektet raportuese me qëllim të identifikimit dhe verifikimit të pronarit përfitues do të zbatojnë masa të kujdesit të duhur për identifikimin e strukturës drejtuese të OJQ-së, kryesuesin e kuvendit</p>	<p>1. Za nevladine organizacije osnovane shodno Zakonu o slobodi udruživanja u nevladine organizacije na Kosovu, obveznici izveštavanja će u cilju utvrđivanja i verifikacije identiteta stvarnog vlasnika primeniti mere dužne pažnje radi utvrđivanja upravljačke strukture NVO, predsedavajućeg</p>	<p>1. For Non-Governmental Organizations established based on the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations in Kosovo, reporting entities in order to identify and verify the beneficiary owner will implement due diligence measures to identify the governing structure of the NGO, the</p>

<p>të anëtarëve për shoqatën (ose anëtarët e organit të ndërmjetëm kur është e aplikueshme), anëtarët e bordit drejtues për fondacione dhe institute, si dhe zyrtarin e lartë menaxhues për të tri format organizuese të themelimit të OJQ-ve.</p> <p>2. Përfaqësuesi i autorizuar sipas Ligjit për Lirinë e Asocimit në Organizata Jo Qeveritare në Kosovë, është person përgjegjës për ofrimin e informatave sipas paragrafit 1 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Identifikimii pronarit përfitues për kompanitë e listuara në bursat ndërkombëtare</p> <p>Në rastet kur klienti apo pronari përfitues është një kompani aksionare e listuar në një bursë të njohur financiare jashtë vendit dhe është subjekt i detyrimeve për raportim në një autoritet rregullator nuk është e nevojshme të identifikohet dhe verifikohet identiteti i aksionarëve të kompanisë. Për qëllime të këtij udhëzimi, bursë e njohur financiare do të konsiderohen bursat e</p>	<p>Skupštine članova udruženja (ili imena članova srednjeg organa kad se aplicira, članova upravnog odbora za fondacije i institucije, takode i visokog rukovodioca za tri forme organizacije za osnivanje NVO.</p> <p>2. Shodno Zakonu o slobodi udruživanja u nevladine organizacije na Kosovu, ovlašćeni predstavnik je lice odgovorno za pružanje informacija iz stava 1 ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 9. Utvrđivanje stvarnog vlasnika kompanija kotiranih na međunarodnim berzama</p> <p>U slučajevima kad je klijent ili stvarni vlasnik deoničarsko društvo kotirano na priznatoj finansijskoj berzi u inostranstvu i podleže obavezi prijavljivanja regulatornom telu, nije potrebno utvrđivanje i verifikovanje identiteta deoničara tog društva. Za potrebe ovog Uputstva, priznatim finansijskim berzama smatraju se berze država članica</p>	<p>chairperson of the assembly for associations (the members of the intermediate body when applicable), members of the board of directors for foundations and institute and senior managing officer in three organisation forms of the establishments of NGOs.</p> <p>2. The authorized representative according to the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations in Kosovo, is a responsible person for providing information according to paragraph 1 of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Identification of the beneficial owner for companies listed on international stock exchanges</p> <p>In the cases where the client or beneficial owner is a joint stock company listed on a recognized financial stock exchange abroad and is subject to mandatory reports with a regulatory authority it is not necessary to identify and verify the identity of the company shareholders. For the purposes of this guidance, recognized financial stock exchange will be</p>
---	---	---

<p>vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Në këto raste do të kërkohet Numri Identifikues Ndërkombëtar i Letrave me Vlerë për bursën respektive (ISIN - international securities identification number).</p>	<p>Organizacije za ekonomsku saradnju i razvoj. U tim slučajevima traži se Međunarodni identifikacioni broj hartija od vrednosti kod date berze ((ISIN - international securities identification number).</p>	<p>considered stock exchanges of member countries of the Organization for Economic Co-operation and Development. In these cases, the International Securities Identification Number will be required. (ISIN - international securities identification number).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Nivelet e kontrollit të pronësisë përfitues</p>	<p style="text-align: center;">Član 10. Nivoi kontrole stvarnog vlasništva</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Beneficial ownership control levels</p>
<p>Ekziston një qasje me 3 nivele për përcaktimin e pronarit përfitues në Ligjin për PPP/LFT, e cila vlen edhe për regjistrimin e pronarëve përfitues të personave juridikë. Pika fillestare është gjithmonë nëse ekziston apo mund të identifikohet ndonjë person brenda Nivelit 1 (një person fizik me kontroll përmes pronësisë). Nëse është kështu, ai person (ose persona) duhet të trajtohet si pronari përfitues. Nëse nuk ekziston ose nuk mund të identifikohet asnjë person brenda Nivelit 1, ose nëse një person brenda Nivelit 1 është identifikuar, por ka arsye për të besuar se një person tjetër fizik po ashtu po ushtron kontrollin përfundimtar mbi personin juridik me mjete të tjera, duhet të kërkohet në Nivelin 2. Në situatën e dytë,</p>	<p>U Zakonu o SPN/BFT postoji pristup za utvrđivanje stvarnog vlasnika od 3 nivoa, koji važi i za registraciju stvarnih vlasnika pravnih lica. Polazna tačka uvek je da li postoji ili može da se utvrdi neko lice na Nivou 1 (fizičko lice koje vrši kontrolu po osnovu vlasništva). Ako je to slučaj, to lice (ili lica) tretiraju se kao stvarni vlasnik. Ako ne postoji ili ne može da se utvrdi nijedno lice na Nivou 1, ili ako je neko lice na Nivou 1 utvrđeno ali ima razloga da se veruje da drugo fizičko lice takođe vrši krajnju kontrolu nad pravnim licem na druge načine, treba preći na Nivo 2. U ovom drugom slučaju, i lice sa Nivoa 1 i neko drugo lice sa Nivoa 2 su stvarni vlasnici. Ako nema nikoga na Nivoima 1 i 2, fizičko lice na Nivou 3</p>	<p>There is a 3 level approach to determining the beneficial owner in the Law on PML/CTF, which also applies to the registration of beneficial owners of legal persons. The starting point is always whether a person exists or can be identified within Level 1 (a natural person with control through ownership). If so, that person (or persons) must be treated as the beneficial owner. If no person within Level 1 exists or cannot be identified, or if a person within Level 1 has been identified but there is a reason to believe that another natural person is also exercising ultimate control over the legal person by other means, must be searched at Level 2. In the second situation, both the person within Level 1 and any person within Level 2 are</p>

<p>si personi brenda Nivelit 1 dhe ndonjë person brenda Nivelit 2 janë pronarë përfitues. Nëse askush nuk është brenda Niveleve 1 dhe 2, një person fizik brenda Nivelit 3 (zyrtar i lartë menaxhues) do të jetë pronari përfitues.</p>	<p>(visoki rukovodilac) biće stvarni vlasnik.</p>	<p>beneficial owners. If no one is within Levels 1 and 2, a natural person within Level 3 (senior management officer) will be the beneficial owner.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Kontrolli përmes pronësisë - Niveli 1</p>	<p style="text-align: center;">Član 11. Kontrola po osnovu vlasništva - Nivo 1</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Control by ownership - Level 1</p>
<p>1. Kuptimi i kontrollit përmes pronësisë</p>	<p>1. Znaçenje kontrole po osnovu vlasništva</p>	<p>1. Understanding control by ownership</p>
<p>1.1. Pronari përfitues është individi i cili ka kontroll përmes pronësisë. Kontrolli përmes pronësisë përcaktohet si mbajtja e më shumë se 25% të aksioneve ose të të drejtave të votës në një person juridik, me të drejtën për të emëruar ose shkarkuar shumicën e drejtorëve të kompanisë ose zyrtarëve përkatës për persona të tjerë juridikë ose që kanë të drejta të caktuara mbi pasuritë e personit juridik në disa raste. Përveç kësaj, në rastin e fondacioneve përkufizimi përfshin personat që përndryshe përfitojnë nga fondacioni. Kjo pasqyron faktin se fondacionet, ndryshe nga personat e tjerë juridikë, mund të kenë përfitues.</p>	<p>1.1. Stvarni vlasnik je pojedinac koji ima kontrolu po osnovu vlasništva. Kontrola po osnovu vlasništva definiše se kao držanje više od 25% deonica ili glasačkih prava u pravnom licu, sa pravom da imenuje ili razrešava većinu direktora kompanije ili odnosnih službenika u drugim pravnim licima, ili imanje određenih prava nad imovinom pravnog lica u nekim slučajevima. Pored toga, u slučaju fondacija, definicija obuhvata lica koja inače imaju koristi od fondacije. To odražava činjenicu da fondacije, za razliku od drugih pravnih lica, mogu imati korisnike.</p>	<p>1.1. Beneficial owner is individual who has control by ownership. Control by ownership is defined as the holding of more than 25% of the shares or voting rights in a legal person, with the right to appoint or discharge most of the directors of the company or relevant officials to other legal entities or to have certain rights over the assets of the legal person in some cases. In addition, in the case of foundations the definition includes persons who otherwise benefit from the foundation. This reflects the fact that foundations, unlike other legal persons, may have beneficiaries.</p>

<p>1.2. Pika fillestare në shumicën e rasteve do të jetë të shqyrtohet nëse aksionet e një personi plotësojnë pragun prej më shumë se 25% të aksioneve ose të të drejtave të votës. Kur merret parasysh madhësia e aksioneve të një personi, duhet pasur parasysh pikat e mëposhtme:</p> <p>1.2.1. ku aksionet ose të drejtat që mbahen bashkërisht nga dy ose më shumë persona, secili person duhet të trajtohet si mbajtës i tërësisë së aksioneve ose të drejtave;</p> <p>1.2.2. kur aksionet ose të drejtat që nuk mbahen bashkërisht janë subjekt i një marrëveshje ndërmjet njerëzve që i mbajnë ato dhe ata do t'i ushtrojnë të drejtat e tyre në të njëjtën mënyrë, secili person që është palë në marrëveshjen duhet të trajtohet si mbajtës i tërësisë së aksioneve ose të drejtave që mbulohen nga marrëveshja; kjo vlen për të drejtat që lidhen me</p>	<p>1.2. Polazna tačka u većini slučajeva biće procena da li nečije deonice zadovoljavaju prag od preko 25% deonica odnosno glasačkih prava. Prilikom procene nečijeg deoničarskog udela, treba uzeti u obzir sledeće tačke:</p> <p>1.2.1. kad deonice ili prava zajednički drže dva ili više lica, svako lice teba tretirati kao držaoca celine deonica ili prava;</p> <p>1.2.2. kad su deonice ili prava koje se ne drže zajednički predmet ugovora između lica koja ih drže i ta lica će vršiti svoja prava na isti način, svako lice koje je strana u takvom ugovoru treba tretirati kao držaoca celine deonica ili prava obuhvaćenih ugovorom; isto važi i za prava koja se odnose na deonice ili na druga prava;</p>	<p>1.2. The starting point in most cases will be consider whether a person's shares meet the threshold of more than 25% of the shares or voting rights. When considering the size of a person's shares, the following points should be considered:</p> <p>1.2.1. where shares or rights held jointly by two or more persons, each person shall be treated as the holder of the entirety of the shares or rights;</p> <p>1.2.2. where shares or rights not jointly held are the subject of an arrangement between the persons holding them and will exercise their rights in the same way, each person who is a party to the arrangement should be treated as the holder of the whole of shares or rights covered by the arrangement; this applies to rights related to shares or other rights;</p>
---	---	--

<p>aksionet ose të drejtat e tjera;</p> <p>1.2.3. aksionet që mbahen nga një i emëruar në emër të një personi tjetër duhet të trajtohen se i përkasin atij personi tjetër, e jo të emëruarit;</p> <p>1.2.4. kur një person kontrollon një të drejtë që mbahet nga një person tjetër, personi me kontroll duhet të trajtohet si mbajtës i së drejtës. Ky është po ashtu sikurse edhe personi që zyrtarisht e mban atë nëse ky i fundit ka gjithashtu kontroll. Nëse, megjithatë, personi që e mban zyrtarisht atë duhet të veprojë tërësisht ashtu siç udhëzohet nga një tjetër, vetëm ai person tjetër duhet të trajtohet si mbajtës i së drejtës.</p> <p>1.3. Është e rëndësishme të theksohet se nëse një individ veçohet brenda një strukture të pronësisë në më shumë se një mënyrë, duhet të shqyrtohet vlera e secilit prej aksioneve të individit me qëllim që të vlerësohen aksionet e</p>	<p>1.2.3. deonice koje drži neko ko je imenovan u ime drugog lica treba tretirati kao da pripadaju tom drugom licu, a ne imenovanom licu;</p> <p>1.2.4. kad jedno lice kontroliše pravo koje drži drugo lice, ono lice koje vrši kontrolu treba tretirati kao nosioca prava. To je isto kao lice koje ga zvanično drži ako to lice takođe vrši kontrolu. Međutim, ako lice koje ga zvanično drži treba da postupa u celospolozima drugog, samo to drugo lice treba tretirati kao nosioca prava.</p> <p>1.3. Važno je pomenuti da, ukoliko je neki pojedinac izdvojen u okviru vlasničke strukture na više od jednog načina, treba uzeti u obzir vrednost svake pojedinačne deonice da bi se procenila ukupna vrednost deonica.</p>	<p>1.2.3. shares held by an nominee on behalf of another person must be treated as belonging to that person, other than the nominee;</p> <p>1.2.4. when a person controls a right held by another person, the person with control must be treated as the holder of the right. This is the same as the person who officially holds it if the latter also has control. If, however, the person formally holding it must act entirely as instructed by another, only the other person should be treated as the holder of the right.</p> <p>1.3. It is important to note that if an individual is segregated within an ownership structure in more than one way, the value of each of the individual's shares should be considered in order to assess the</p>
--	--	---

<p>përgjithshme.</p> <p>1.4. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se edhe nëse aksionet e një individi nuk përmbushin pragun e më shumë se 25% të aksioneve ose të të drejtave të votimit, ai individ do të vazhdojë të jetë një pronar përfitues nëse ai ose ajo ka të drejtë të emërojë ose të shkarkojë shumicën e zyrtarëve të personit juridik.</p> <p>1.5. Një faktor tjetër që duhet pasur parasysh është se mund të ekzistojë një individ brenda një strukture pronësie që nuk përmbush asnjë nga testet për kontroll nëpërmjet pronësisë (d.m.th. është jashtë Nivelit 1), por që ushtron kontroll nëpërmjet mjeteve të tjera (domethënë në Nivelin 2), në përputhje me parimet e paraqitura më poshtë.</p> <p>2. Mbajtja e aksioneve apo të drejtave drejtpërdrejt</p> <p>2.1. Një person që mban një aksion ose të drejtë në emrin e tij ose saj mban atë të drejtë në mënyrë të drejtpërdrejtë.</p>	<p>1.4. Isto tako važno je pomenuti da čak i kad deonice jednog pojedinca ne zadovoljavaju prag od preko 25% deonica odnosno glasačkih prava, dati pojedinac je i dalje stvarni vlasnik ako ima pravo da imenuje ili razreši većinu službenika pravnog lica.</p> <p>1.5. Još jedan činilac koji treba imati u vidu jeste da u vlasničkoj strukturi može postojati pojedinac koji ne zadovoljava nijedan test za kontrolu po osnovu vlasništva (tj. budući da ostaje izvan Nivoa 1), ali koji vrši kontrolu na druge načine (tj. na nivou 2), u skladu sa dole navedenim načelima:</p> <p>2. Neposredno držanje deonica ili prava</p> <p>2.1. Lice koje drži deonicu ili pravo u svoje ime, direktan je nosilac tog prava. To može da drži neko lice</p>	<p>overall shares.</p> <p>1.4. It is also important to note that even if an individual's shares do not meet the threshold of more than 25% of the shares or voting rights, that individual will continue to be a beneficial owner if he or she has the right to appoint or discharge most of the officials of the legal entity.</p> <p>1.5. Another factor to consider is that there may be an individual within an ownership structure who does not pass any of the ownership control tests (i.e. is out of Level 1) but who exercises control through other means (i.e. Level 2), in accordance with the principles set out below.</p> <p>2. Holding shares or rights directly</p> <p>2.1. A person who holds a share or right on his or her behalf directly holds that right. This can be held by the person</p>
---	--	--

<p>Kjo mund të mbahet nga personi vetëm ose bashkërisht me një person tjetër. Aksionet e drejtpërdrejta në përgjithësi regjistrohen në dokumentet kushtetuese të një personi juridik siç është regjistri i aksioneve, por informacionet nuk do të jenë përfundimtare pasi që është gjithashtu e nevojshme të shqyrtohet nëse vlen ndonjë nga faktorët e sipërpërmendur.</p>	<p>samo, ili zajednički sa drugim licem. Direktne deonice obično se evidentiraju u osnivačkim aktima datog pravnog lica kao što je registar deonica, ali time informacije neće biti konačne jer je takođe potrebno da se ispita da li za datu situaciju važi neki od gore navedenih činilaca.</p>	<p>solely or jointly with another person. Direct shares are generally recorded in the legal documents of a legal entity such as a share register, but the information will not be final as it is also necessary to consider whether any of the above mentioned factors apply.</p>
<p>2.2. Kjo ilustruhet me shembujt në shtojcën 1</p>	<p>2.2. To ilustruju primeri u dodatku 1</p>	<p>2.2. This is illustrated by the examples in Appendix 1</p>
<p>3. Mbajtja e aksioneve apo të drejtave të votës në mënyrë indirekte – të emëruarit</p>	<p>3. Posredno držanje deonica ili glasačkih prava – imenovano lice</p>	<p>3. Holding shares or voting rights indirectly - nominees</p>
<p>3.1. Pronësia indirekte përmes të emëruarve do të ekzistojë kur një individ (emëruesi) emëron një palë tjetër (të emëruarin) për të mbajtur aksione apo të drejta në një person juridik në emër të tij. I emëruari do të regjistrohet në regjistrin e aksioneve ose në dokumente të tjera zyrtare të personit juridik si mbajtës i aksioneve ose të drejtave në fjalë dhe identiteti i emëruesit nuk do të zbulohet. I emëruari mund të jetë një subjekt</p>	<p>3.1. Posredno vlasništvo preko imenovanih lica postojaće kad pojedinac (imenitelj) imenuje drugu stranu (imenovanog) da u njegovo ime drži deonice ili prava u pravnom licu. Imenovani će biti upisan u registar deonica ili drugi službeni dokument pravnog lica kao držalac predmetnih deonica ili prava, a identitet imenitelja neće biti otkriven. Imenovani može biti pravno lice (često pružalac korporativnih usluga)</p>	<p>3.1. Indirect ownership through nominees shall exist when an individual (nominator) nominates another party (nominator) to hold shares or rights in a legal person on his behalf. The nominee shall be registered in the register of shares or other official documents of the legal person as the holder of the shares or rights in question and the identity of the nominator shall not be disclosed. The nominee may be an entity (often a</p>

<p>(shpesh ofruet i shërbimeve të korporatave) ose një person fizik, zakonisht një anëtar i familjes, mik ose bashkëpunëtor i emëruesit. Ndonëse shpesh ka arsye legjitime për përdorimin e aksionarëve të emëruar, kjo mund të ofrojë gjithashtu një mjet për të fshehur pronësinë dhe kontrollin përfundimtar të një personi juridik. Për shembull, një person fizik mund të mbajë në mënyrë indirekte një interes të shumicës në personin juridik nëpërmjet përdorimit të aksionarëve të emëruar ose personave pa integritet ku secili ka një interes minimal dhe në këtë mënyrë fshihet identiteti i personit fizik i cili aktualisht mban kontroll efektiv.</p>	<p>ili fiziçko lice, obično član porodice, prijatelj ili saradnik imenitelja. Iako često postoje legitimni razlozi za korišćenje imenovanih deoničara, to može da posluži i kao način za prikrivanje vlasništva i kontrolu u krajnjoj instanci nad pravnim licem. Na primer, fizičko lice može da posredno drži većinski interes u pravnom licu korišćenjem imenovanih deoničara ili lica bez integriteta pri čemu svaki od njih ima minimalni interes, te da na taj način prikriva identitet fizičkog lica koji vrši istinsku efektivnu kontrolu.</p>	<p>corporate service provider) or a natural person, usually a family member, friend or associate of the nominee. While there are often legitimate reasons for using named shareholders, this can also provide a means of concealing the ownership and ultimate control of a legal person. For example, a natural person may indirectly retain a majority interest in the legal person through the use of nominated shareholders or persons without integrity where each has a minimal interest and thus conceals the identity of the natural person who currently holds effective control.</p>
<p>3.2. Edhe pse marrëdhëniet e të emëruarve janë të ndryshme nga situata ku një person kontrollon ushtrimin e të drejtave të mbajtura nga një tjetër ose ushtron kontroll me mjete të tjera, në praktikë mund të ketë një shkallë të mbivendosjes në disa raste. Në mënyrë të ngjashme, kur një i emëruar është një subjekt, mund të ketë gjithashtu mbivendosje me situatën e</p>	<p>3.2. Iako se odnos imenovanih razlikuje od situacije u kojoj jedno lice kontroliše ostvarivanje prava koja ima neko drugi, ili vrši kontrolu na druge načine, u praksi u nekim slučajevima može doći do preklapanja u izvesnoj meri. Slično tome, kad je imenovani pravno lice, može doći do preklapanja u dole obrazloženoj situaciji u smislu lanca</p>	<p>3.2. Although the relationship of the nominees is different from the situation where one person controls the exercise of the rights held by another or exercises control by other means, in practice there may be a degree of overlap in some cases.</p> <p>Similarly, when a nominee is an entity, there may also be an overlap</p>

<p>shqyrtuar më poshtë në lidhje me zinxhirët e pronësisë.</p> <p>3.3. Kjo ilustrohet me shembujt në shtojcën 2</p> <p>4. Mbajtja e aksioneve apo të drejtave të votës në mënyrë indirekte – zinxhirët e pronësisë</p> <p>4.1. Mbajtja indirekte përmes zinxhirëve të pronësisë do të ndodhin kur struktura e pronësisë së personit juridik përfshin një ose më shumë subjekte të tjera. Subjektet në zinxhir mund të jenë persona juridikë apo marrëveshje ligjore. Rrjedhimisht, është e nevojshme të shikohet zinxhiri i pronësisë në të gjitha interesat e ndryshme pronësore për të siguruar që identifikohen të gjithë personat fizikë me zotërim të tërthortë të aksioneve ose të drejtave në personin juridik mbi pragun 25% të legjislacionit.</p> <p>4.2. Interesat e pronësisë brenda një zinxhiri që duhet të përcaktohen ka</p>	<p>vlasništva.</p> <p>3.3. To ilustruju primeri u dodatku 2</p> <p>4. Posredno držanje deonica ili glasačkih prava – lanci vlasništva</p> <p>4.1. Posredno držanje preko lanca vlasništva nastaje kad vlasnička struktura pravnog lica obuhvata jedno ili više drugih pravnih lica. Subjekti u lancu mogu biti pravna lica ili pravni ugovori. Prema tome, nužno je sagledati lanac vlasništva u svim njegovim različitim imovinskim interesima kako bi bili sigurni da je utvrđen identitet svih fizičkih lica sa posrednim vlasništvom nad deonicama ili pravima u pravnom licu preko zakonom propisanog praga od 25%.</p> <p>4.2. Vlasnički interesi u lancu koje treba prepoznati najverovatnije će biti</p>	<p>with the situation discussed below regarding ownership chains.</p> <p>3.3. This is illustrated by the examples in Appendix 2</p> <p>4. Holding shares or voting rights indirectly - ownership chains</p> <p>4.1. Indirect retention through ownership chains shall occur when the ownership structure of the legal person includes one or more other entities. The entities in the chain can be legal persons or legal agreements.</p> <p>Consequently, it is necessary to look at the chain of ownership in all the various property interests to ensure that all natural persons with indirect ownership of shares or rights in the legal person are identified above the 25% threshold of the legislation.</p> <p>4.2. Ownership interests within a chain to be defined are most likely shares or</p>
---	---	--

<p>shumë të ngjarë të jenë aksione ose të drejta (ose mundësisht interesa përfitues në rastin e fondacioneve), por nuk është e mundur të jepet një listë përfundimtare e interesave përkatëse të pronësisë, sepse kjo do të varet nga karakteristikat e veçanta të subjekteve që ndërhyjnë, disa prej të cilëve mund të përcaktohen sipas ligjeve të juridiksioneve të tjera. Sidoqoftë, në përgjithësi, nëse një person juridik ndërhyrës ose marrëveshje ligjore ka të drejta pronësie në një person juridik, që do ta bënte personin juridik ndërhyrës ose marrëveshjen ligjore si pronar përfitues të personit juridik nëse ata do të ishin persona fizikë, çdo person fizik që është pronar përfitues i personit juridik ndërhyrës ose marrëveshja ligjore do të jetë pronar përfitues i personit juridik në fjalë.</p>	<p>deonice ili prava (ili možda interes korisnika u slučaju fondacija), ali nije moguće sačiniti konačni spisak odnosnih vlasničkih interesa jer bi to zavisilo od konkretnih karakteristika umešanih subjekata, od kojih bi neki mogli biti definisani zakonima drugih jurisdikcija. Međutim, generalno uzev, ako neko umešano pravno lice ili pravni ugovor ima imovinsko pravo u nekom pravnom licu, koje bi umešano pravno lice ili pravni ugovor učinilo stvarnim vlasnikom pravnog lica ako bi to bila fizička lica, svako fizičko lice koje je stvarni vlasnik umešanog pravnog lica ili pravnog ugovora biće stvarni vlasnik predmetnog pravnog lica.</p>	<p>rights (or possibly beneficial interests in the case of foundations), but it is not possible to provide a final list of relevant ownership interests, as this would depend on the particular characteristics of the intermediating entities, some of which may be determined by the laws of other jurisdictions. However, in general, if an intermediating legal person or legal arrangement owns ownership rights in a legal person, which shall turn the intermediating legal person or legal arrangement into beneficial owner of the legal person, if they were natural persons, any natural person is the beneficial owner of the intermediating legal person or the legal agreement shall be the beneficial owner of the legal person in question.</p>
<p>4.3. Një mbajtje indirekte brenda një zinxhiri të pronësisë mund të paraqitet në një rën nga dy mënyrat.</p>	<p>4.3. Posredno držanje unutar lanca vlasništva može nastati na dva načina.</p>	<p>4.3. An indirect holding within a chain of ownership can be represented in one of two ways.</p>
<p>4.4. E para është kur një subjekt mban më</p>	<p>4.4. Prvi je kad subjekat drži više od</p>	<p>4.4. The first is when an entity holds more</p>

<p>shumë se 25% të aksioneve ose të drejtave në personin juridik dhe një individ ka shumicën e aksioneve (d.m.th. 51% + aksione ose të ngjashme) në atë subjekt kështu që mund të kontrollojë ato aksione ose të drejta. Pjesa më e madhe e aksioneve mund të mbahet drejtpërsëdrejti, por gjithashtu mund të mbahet nëpërmjet një zinxhiri pronësie me individin që zotëron shumicën e aksioneve në secilin subjekt ndërhyrës.</p>	<p>15% deonica ili prava u pravnom licu a neki pojedinac ima većinu deonica (tj. 51% + deonica ili slično) u datom subjektu tako da može kontrolisati te deonice ili prava. Najveći deo deonica može se držati direktno, ali se isto tako može držati preko lanca vlasništva sa pojedincom koji poseduje većinu deonica u svakom umešanom subjektu.</p>	<p>than 25% of the shares or rights in the legal entity and an individual owns the majority of the shares (e.g. 51% + shares or similar) in that entity so it can control those shares or rights. The majority of the shares can be held directly, but can also be held through a chain of ownership with an individual owning the majority of shares in each intermediating entity.</p>
<p>4.5. E dyta është kur mbajtja e aksioneve ose të drejtave nga një individ në personin juridik ndahet në pjesë të veçanta të një zinxhiri të pronësisë për atë person juridik (përfshirë brenda më shumë se një zinxhiri të pronësisë), por që, kur mbledhen së bashku, arrijnë në më shumë se 25 %. Kjo është përmendur në shembujt më poshtë si provë e kuantifikimit.</p>	<p>4.5. Drugi je kad se držanje deonica ili prava nekog pojedinca u pravnom licu podeli na zasebne delove lanca vlasništva datog pravnog lica (obuhvaćene više nego samo jednim lancem vlasništva) ali koji, kad se spoje, zajedno iznose više od 25%. To je navedeno u donjim primerima kao dokaz kvantifikacije.</p>	<p>4.5. The second is when the holding of shares or rights by an individual in the legal person is divided into separate parts of a chain of ownership for that legal person (included within more than one chain of ownership), however, when brought together, reach more than 25%. This is mentioned in the examples below as an evidence of quantification.</p>
<p>4.6. Një individ i cili ka pronësi indirekte në një rën ose në të dyja këto mënyra është pronar përfitues i personit</p>	<p>4.6. Pojedinac koji ima posredno vlasništvo na bilo koji od ta dva načina jeste stvarni vlasnik pravnog</p>	<p>4.6. An individual who has indirect ownership in one or both of these ways is the beneficial owner of the</p>

